

## Shtojca E

Kjo shtojcë përshkruan rregullat që do të zbatohen në lidhje me zgjidhjen e disbalancave në rastet kur përdorimi i burimeve të balancimit nga OST shkakton disbalanca tek pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Ky është një rast i veçantë ku mund të preket prodhimi i planifikuar për HEC Ashta për shkak të urdhrave të dispeçerimit nga OST për të rritur ose ulur prodhimin e KESH/ HEC Vau Dejës për shkak të sistemit të balancimit.

1. Informacioni i shpërndarë ndërmjet HEC Ashta, KESH dhe OSHEE si dhe planifikimi i një dite në avancë udhëhiqet nga marrëveshjet e dakordësuara midis pjesëmarrësve të tregut.
2. Rastet kur OST përdor rezervat e kontrollit terciar, do të konsiderohen si korrigjime të OST si me poshtë:  
Përdorimi i kontrollit terciar do të identifikohet qartë pasi ai bazohet tek urdhërat direkte të dispeçerimit nga OST për KESH, për të filluar/ndaluar një njësi tek Vau i Dejës. Sasia e energjisë regjistrohet nga matës tek sistemi i OST, për rezervën terciare të kontrollit. Impakti për këtë lloj rezerve do të zbritet nga disbalanca AE për të arritur vlerën korrekte të disbalancës për EA.
3. OST do të regjistrojë këto sasi si kosto shtesë tek llogaria e balancimit, për t'iu nënshtruar marrëveshjes rregullatore në përputhje me Rregullat e Përkohshme të Balancimit.
4. Para çdo ndryshimi tek marrëveshjet e dakordësuara nga pjesëmarrësit e tregut sipas paragrafit 1 të kësaj Shtojce, OST do të njoftohet paraprakisht për të siguruar që nuk ka pengesa teknike ose rregullatore për ta zbatuar këtë marrëveshje të propozuar. ERE duhet të marrë pëlqimin dhe duhet të konsultohet me palët e përfshira për ta ndryshuar marrëveshjen.
5. Kjo shtojcë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas muajit kur do të merret vendimi nga ERE. OST duhet të raportojë në ERE pas gjashtë muaj funksionimi dhe duhet të propozojë ndryshime nëse është e nevojshme.